



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavake

Anr.153/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të vendosjes së postereve në hapsira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Junik, i shqiptohet dënimini më gjobë në vlerë prej 3,300.00 (tremijë e treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 07.06.2017, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017 aktivistet e koalicionit PDK-AAK-NISMA kane vërejtur se ne Junik ne lagjen Agim Ramadani subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka vendosur posterat në shtylla publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4, pika 1, e Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së, dhe konsideron se vendosja e materialeve zgjedhore në shtylla publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në kërkesën për përgjigje në ankesë dërguar subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me datë 07.06.2017, nuk kanë jep ndonjë sqarim lidhur me ankesën. Koalicioni PDK-AAK-NISMA, me datën 08.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës, Anr.153/2017, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson nga fotografia e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët se subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtylla publike, veprim ky që është në

kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njostimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik, është shkelur nen 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti në fjalë, janë vendosur në ngjitur në shtylla publike .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtylla publike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për térheqjen e ankesës Anr.153/2017 të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është ne interesin e publikut dhe se në këtë rast térheqja e njërsë prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në nen 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Térheqja e njërsë prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është ne interesin e publikut ose ne interesin ligor të palëve të tjera në procedim*”. Paneli nuk e bëri lejimin e térheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i térhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 153/2017 më datën 09.06.2017

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*